



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 13 qershor 2017

Lënda nr. 2015-02

Ramadan Hamza

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 13 qershor 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Noora AARNIO, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar me 4 mars 2015.

II. FAKTET

2. Faktet e lëndës të paraqitura nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë:
 - Në një kohë të pasaktësuar në vitin 1986 ankuesi kishte blerë një pronë nga D. X. Djemtë e shitësit gjithashtu kishin rënë dakord për atë shitje. D.X. kishte vdekur në një datë të mëvonshme të pasaktësuar.

- Ankuesi ishte përpjekur që ta regjistronte pasurinë në emrin e tij, por nuk kishte mundur ta bënte këtë për shkak se djemtë e shitësit kishin refuzuar të nënshkruanin dokumentet e nevojshme.
- Ankuesi e kishte ngritur çështjen e tij në gjykatat e Kosovës.
- Me 8 dhjetor 2011, Gjykata Komunale e Rahovecit kishte lëshuar një aktgjykim në të mirë të paditësit.
- Pala kundërshtuese ishte ankuar.
- Me 1 dhjetor 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës kishte lëshuar një aktgjykim lidhur me këtë çështje. Kjo gjykatë e kishte shfuqizuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe e kishte kthyer çështjen përsëri për rishqyrtim.
- Lënda aktualisht është e pazgjidhur në Gjykatën Komunale në Rahovec.

III. ANKESAT

3. Ankuesi pohon se e drejta e tij për gëzimin paqësor të pronës së tij është e garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Ai argumenton se një nga palët kundërshtuese ka ushtruar ndikim të padrejtë në gjykata dhe se procedurat ishin tejzgjatur në mënyrë të paarsyeshme. Ai kërkon nga Paneli që t'i ndihmojë në marrjen e një vendimi lidhur me meritat e rastit.

IV. LIGJI

4. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
5. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
6. Sipas rregullit 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. Kjo dispozitë më tej parashikon që Paneli nuk është kompetent të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës.
7. Pasi që kjo ankesë ka të bëjë me një çështje që aktualisht është në pritje në gjykatën e Kosovës, Paneli konkludon se ankesa nuk bie në kuadër të juridiksionit të Panelit siç është formuluar në Rregullën 25, paragrafi 1, të Rregullores së Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.
8. Ankuesi nuk ka gjetur asnjë bazë tjetër mbi të cilën shkeljet e supozuara të të drejtave të tij themelore mund t'i atribuohen EULEX-it në mënyrë që ky rast të mund të shpallet i pranueshëm.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë që të shqyrtoj këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese